



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË ASETVE
SEKTORI JURIDIK**

Nr. 1042/prot

Koplik më: 17 / 04 /2026

PROJEKT -VENDIM

Nr _____, Datë ____/ ____/ 2026

PËR

**MIRATIMIN NË PARIM TE DHËNIES ME QIRA/NE PËRDORIM TË SIPERFAQES
PYJORE/KULLOSORE PREJ 0.5829 HA , NË ZONEN KADASTRALE 3834 , NË
PASURINË ME NR.S1 QË SHTRIHET NË NGASTREN/NENGASTREN 101a, NË
NJESINE ADMINISTRATIVE SHKREL NË PRONËSI TË BASHKISË MALËSI E
MADHE**

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe , në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 pika “e/1”, neni 9 pika 1.2 a, neni 27 pika 5, urdherit të Kryetarit të Bashkisë nr.49 datë 13.05.2024. Ligjin nr. 57/2020 “ Për Pyjet ”, VKM nr.888 dt.27.12.2022 “Per rastet e dhenies ne perdorim dhe per ndryshimin e kategorise se perdorimit procedurat dhe dokumentacioni perkates per ndryshimet e siperfaqeve”., Udhëzimi e Ministrit Të Mjedisit nr.1 dt.09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit ,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në perdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” , pika 2 germa a ,pika 7. VKM nr. 559 dt.29.07.2022 te Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave për dhënien për shfytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhime drusore dhe jo drusore pyjore” ” si dhe bazuar në VKM. Nr.433, datë 08.06.2016 , të Këshillit të Ministrave , “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike ,sipas listave të inventarit , dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave /Bashkive ‘’, të ndryshuar.

VENDOSI:

Që ti propozojë Këshillit të Bashkisë Malësi Madhe :

I – Të miratojë në parim dhënien me qira në favor të tretëve të pasurisë së llojit Pyll trungishte

- a. Siperfaqen pyjore prej 0.5829 ha në zonen kadastrale ,me index harte K-34-52(242-D), në pasurinë me nr. S1 që shtrihet në ngastren/nengastren 101a, pjese e ekonomise pyjore “Fushë e Zeze” në pronësi të Bashkisë Malësi e Madhe sipas VKM. Nr.433, datë 08.06.2016 , të Këshillit të Ministrave , “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike ,sipas listave të inventarit , dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave /Bashkive ‘’, të ndryshuar ,

II-Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit , sipas Udhëzimit të Ministrit Të Mjedisit nr.1 dt.09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërimit ,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”

III-Vlera minimale e qirase do të jetë 64 119 (gjashtëdhjetëkatërmijënjëqindentëmbëdhjetë) lekë/vit , llogaritur mbi raportin e studimit tekniko ekonomik për dhënie në përdorim të fondit pyjor të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Malësi e Madhe për qëllime pushimi, argëtimi, veprimtari turistike, kampingje të hartuar nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve , dhe tarifat e përcaktuara në VKM nr. 559 dt.29.07.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave për dhënie për shfytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhime drusore dhe jo drusore pyjore

IV- Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe për vazhdimin e procedurave të metejshme

Faleminderit për mirëkuptimin!





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË ASETEVE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1042 prot

Koplik më: 17 / 04 / 2026

Relacion

PËR

**MIRATIMIN NË PARIM TE DHËNIES ME QIRA/NE PËRDORIM TË SIPERFAQES
PYJORE/KULLOSORE PREJ 0.5829HA , NË ZONEN KADASTRALE 3834, NË
PASURINË ME NR.S1 QË SHTRIHET NË NGASTREN/NENGASTREN 101a, NË
NJESINE ADMINISTRATIVE SHKREL NË PRONËSI TË BASHKISË MALËSI E
MADHE**

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 64 germa c .

Të nderuar këshilltarë

Bazuar në kërkesen nr.972 prot. Date 04.04.2025 e ardhur nga subjekti Zef Qerreti dhe Shoqeria “AL_VISO sh.p.k me administrator Lirim Heqimaj , ne formën e propozimit të pakërkuar sipas pikes 7 të Udhëzimit nr.1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” , ku kanë kërkuar marrjen me qira të sipërfaqes prej 0.5829 ha për zhvillimin e aktivitetit të tyre , ceshtje që është paraqitur edhe në mbledhjen e këshillit me dt. / / 2025 ku nuk ka marrë miratimin e nevojshëm për shkak të pretendimeve se pasuria objekt shqyrtimi është tokë private . Në vijim të këtij pretendimi është verifikuar dokumentacioni përkatës dhe rezulton se sipas certifikatës së pronësisë bashkangjitur , është në pronësi të Bashkisë Malësi e Madhe , duke rrëzuar kështu pretendimin e shqyrtimit të mëparshem . Në këto kushte më lejoni tu paraqes relacionin për raportin mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim të fondit pyjor të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Malësi e Madhe për qëllime pushimi, argëtimi, veprimtari turistike, kampingje të përgatitur nga Drejtoria e Administrimit Pyjor me nr.972/2 prot., datë 27.05.2025.

Ky studim tekniko ekonomik ka për objekt llogaritjen e vlerës minimale të qirasë per qellime pushimi ,argetimi, veprimtari turistike , kampingje për ngastrat pyjore. Mbeshtetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor kullosor rezulton që sipërfaqja Pyll Trungishte prej 0. 5829 ha në ngastrat/nënngastrat nr 101a në ekonominë pyjore“ Fushë e Zezë “ , dhe është në pronësi të Bashkisë Malësi e Madhe .

Sipërfaqja e marrë në studim do ti nënshtrohet procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

Sipërfaqja që kërkohet të jepet në përdorim është 0. 5829 ha.

Në funksion të sipërfaqes që jepet në përdorim , sipas VKM-së nr. 559 dt.29.07.2022 të Këshillit të Ministrave “ Për përcaktimin e tarifave për dhënie për shfytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhime drusore dhe jo drusore pyjore

4.Për qëllime pushimi argëtimi ,për veprimtari turistike , kampingje (kënde lodrash , shëndetësore,shoqërore dhe mjedise sportive , shlodhëse, kulturore etj.				
Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës leke/ha/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet
1.	Pyll trungishte	198 000	132 825	110 000

Vlera minimale e qirasë është 64 119 lekë/vit .

Procedurat që ndiqen për dhënie në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në VKM Nr. 888, datë 27.12.2022 për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre, në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”.

Bazuar në sa më sipër , propozojmë miratimin në parim të dhënies me qira/ në përdorim të sipërfaqes prej 0, 5829ha.

Faleminderit për mirëkuptimin!




KRYETAR
TONIN MARINAJ

REPUBLICA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

PRONARI/BASHKËPRONARËT		
Emri i Personit Juridik	Nr. Personal NIPT	Pjesa(-/-)
BASHKIA MALESIE MADHE	K484207011	1/1

Numri i Pasurisë	869		
Kodi Unik	3834009022		
Zona Kadastrale	3834		
Lloji i Pasurisë	PYLL		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Totali: 11856	Truall: 0	Ndërtesë: 0
Vlera Aktuale e Pasurisë	1		
Adresa e Pasurisë	Malesi e madhe, Malesi e madhe, Rr.: malesi e madhe		

DREJTORI Miljan Gjekaj 	Eliverta cobaj 	Digitally signed by: Eliverta cobaj Date: 2024.01.31 02:19:38 +02'00'	Izaida Nehanaj 	Digitally signed by: Izaida Nehanaj Date: 2024.02.06 04:22:50 +02'00'	Arrian Todhri 	Digitally signed by: Arrian Todhri Date: 2024.02.06 04:34:29 +02'00'	Miljan Gjekaj 	Digitally signed by: Miljan Gjekaj Date: 2024.02.06 04:36:49 +02'00'

Miratur me VKM 782, D.06



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 3834009022

(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 3834, Lloji i Pasurisë: PYLL, Nr. i Pasurisë: 869, Sipërfaqja Totale 11856 m²,
(Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale k-34-52-(242-B), Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia Malesi e madhe, Rruga malesi e madhe, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____,
Apartamenti Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 684, Dt. 02/09/2020), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: BASHKIA MALESI E MADHE, Nr. Identifikimi/NIPT K484207011, Pjesa Takuese 1/1,
Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia _____, Rruga KOPLIK, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Vendim i KM (për kalim në pronësi të institucionit shtetëror/apo vendimet e shpronësimit), Nr. 684, Datë: 02/09/2020

Regjistruar: Nr. 00000600, Datë: 29/12/2023

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektivit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHETËRËORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. __, Datë: _____
Regjistruar: Nr. __, Datë: _____
Përshkrimi: sh 24000107 pjesa tjttek vol 8 fq 242 nr.pas 858

DREJTORI
Miljan Gjekaj



Vulosur elektronikisht nga Zyra
Vendore Malësi e Madhe
Date: 2024/01/31 14:18:57 +02'00'
K48420701I2024013114185074ASHK_

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

Eliverta
cobaj

Digitally signed by:
Eliverta cobaj
Date: 2024.01.31
02:19:13 +02'00'

Izaida
Nehanaj

Digitally signed by:
Izaida Nehanaj
Date: 2024.02.06
04:20:55 +02'00'

Ardian
Todhri

Digitally signed by:
Ardian Todhri
Date: 2024.02.06
04:33:49 +02'00'

31/01/2024
Miljan
Gjekaj


Digitally signed by:
Miljan Gjekaj
Date: 2024.02.06
04:36:26 +02'00'



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE			
ZONA KADASTRALE:	3834	KODI UNIK: 3834009022	
NUMRI PASURISË :	869	INDEX I HARTËS:K-34-52-(242-D)	

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1:10000

DREJTORI
(Emri i autorit)



Vulosur elektronikisht nga Zyra
Vendore Malësi e Madhe
Date: 2024/02/06 16:28:14 +02'00'
K4842070112024020616280795014

Data e lëshimit 06 / 02 / 2024

SHPJEGUES

PARCELA
NDERTESA

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Zyra Vendore Malësi e Madhe)